



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR KOMUNITETE

EKSTRAKT

nga procesverbali i mbajtur më 09 janar 2019, në mbledhjen e VII-të (shtatë) të Komitetit për Komunitete, mandati VI.

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 10.35.

Mbledhjen e hapi dhe deri në zgjedhjen e Kryesuesit e kryesoi Valbona Kadriu Podvorica, Zëvendës kryesuese e Komitetit.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti dhe atë: Benjamin Ejupi, Doruntina Hasani, Valmire Lahu, Albina Avdiu, Xhafer Ademi, ndërsa munguan, Bashkim Sylja, Mefail Rama dhe Radisav Perović.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe Liman Zeqiri, shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, Bashkim Bajrami nga Policia Kufitare, Fadil Babatinca nga Stacioni Policor në Podujevë, Skender Shatri dhe Bekim Karaxhija përfaqësues të OSBE-së, dhe përfaqësues të KFOR - LMT.

Miratimi i rendit të ditës

znj.Valbona Kadriu Podvorica, zëvendës kryesuese e Komitetit, e hapi mbledhjen, përshëndeti të pranishmit dhe uroj të gjithëve vitin e ri 2019 duke iu dëshiruar vit të mbarë dhe suksese, shtoi, sigurisht që të gjithëve ju është dërguar thirrja dhe materiali për këtë mbledhje dhe keni parë dhe analizuar këto tema. Vlen të ceket se pas vdekjes së kryesuesit të këtij Komiteti Shaban Ahmeti, janë zhvilluar procedurat përkatëse për zëvendësimin e tij dhe tani anëtar të Komitetit kemi z.Xhafer Ademi të cilit i urojmë suksese, andaj nëse ndokush nga anëtarët nuk ka diçka për shtuar, urdhëroni, nëse jo e hedh në votim rendin e ditës.

Njëzëri u miratua rendi i propozuar i ditës.

z.Liman Zeqiri, shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim – ZKKK, duke uruar të pranishmit për vitin e ri 2019 theksoi, para se të fillojmë me punë, në shenjë respekti, që nga paslufta unë si përfaqësues i ZKKK-së kam pasë nderin dhe respektin që kam bashkëpunuar dhe komunikuar si dhe kam pasë një koordinim të jashtëzakonshëm me të ndjerin Shaban Ahmeti, për të cilin mund të them lirshëm se ka qenë një bashkëpunëtor i shkëlqyeshëm i cili çdoherë ka pasur një komunikim të singertë me të gjitha institucionet lokale por edhe me Shoqata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, prandaj në shenjë respekti për të ndjerin i cili ka qenë çdo herë Kryesues i Komitetit për Komunitete, shprehi rastin të mbajmë 1 minutë heshtje

Mbahet 1 minutë heshtje.

1. Zgjedhja e Kryesuesit të Komitetit për Komunitete

znj.Valbona Kadriu Podvorica, zëvendës kryesuese e Komitetit, edhe njëherë e përsëris që ashtu siç jeni në dijëni, ish Kryesuesi i Komitetit për Komunitete Shaban Ahmeti, ka ndërruar jetë, zëvendësimi i tij është bërë dhe është emëruar z.Xhafer Ademi. Procedurat ligjore parashohin që Kryesuesi i Komitetit për Komunitete propozohet dhe zgjedhët nga anëtarët e këtij Komiteti dhe i njëjti duhet të jetë nga radhët e Komitetit jo shumicë, andaj mund të fillojmë me propozimet e anëtarëve të Komitetit ku secili prej nesh ka të drejtë të propozoj një anëtar/e të Komunitetit jo shumicë për Kryesues të Komitetit.

z.Liman Zeqiri, shef e ZKKK-së, vetëm sa për sqarim, ky është Komitet për Komunitete dhe në kuadër të tij gjithëherë përparësi i jepet një Komuniteti shumicë që është në kuadër të Komuniteteve jo shumicë dhe në kontekst të kësaj dëshiroj të theksoj se çdo herë Kryesuesi i Komitetit për Komunitete në Komunën e Podujevës i takon Komitetit Ashkalinj, mund të jetë edhe ndryshe, por ky Komitet është edhe në përbërje numerikisht më i madh në këtë Komitet por edhe në kuptim të banorëve është më i madh se Komunitetet tjera jo shumicë, prandaj edhe e ceka se Kryesuesi i Komitetit për Komunitete i takon të zgjidhet nga anëtarët e Komitetit Ashkalinj.

znj.Dornuntina Hasani, për pozitën e Kryesuesit/es të Komitetit për Komunitete, propozoj znj.Albina Avdiu.

z.Benjamin Ejupi, theksoi, propozoj anëtarin e ri z.Xhafer Ademi, për Kryesues të Komitetit për Komunitete.

znj.Valmira Lahu, theksoi, propozoj z.Xhafer Ademin për Kryesues të këtij Komiteti. I përmenduri ka qenë përfaqësues edhe më parë në këtë Komitet dhe është i dëshmuar për punë, andaj besoj se ka përvojën dhe angazhimin për të qenë kryesues i Komitetit për Komunitete.

z.Liman Zeqiri, shef e ZKKK-së, theksoi, para se të hedhen në votim propozimet e bëra, konsideroj se do të ishte mirë që të koordinohen dy të propozuarit në mënyrë që të mos ketë keqkuptime eventuale si dhe anëtarët e këtij Komitetit të mos vihen në pozita të rënda se kënd ta votojnë sepse pozita e Kryesuesit nuk është diçka e privilegjuar por vetëm një ngarkesë apo barrë shtesë ta quaj ashtu për atë anëtar/e që zgjedhet Kryesues/e. Andaj kryesuesi duhet të jetë më i afërt me anëtarët e Komitetit, dhe Komunitetet jo shumicë në përgjithësi si dhe duhet të ketë një përvojë dhe angazhim më të madh si në të kaluarën ashtu edhe synime për të ardhmen qoftë në bashkëpunim me organet e Komunës qoftë me institucione dhe shoqata tjera vendore dhe ndërkombëtare, përndryshe ky ishte vetëm një mendim i imi ngase është e drejtë e secilit anëtar/e që me votë të zgjedhin kë të dëshirojnë.

znj.Albina Avdiu, theksoi, paraprakisht falënderoj anëtarin e këtij Komiteti e cila më propozoj mua për kryesuese të Komitetit, mirëpo pasi që z.Xhafer Ademi banon në Podujevë dhe është më afër shumicës së komuniteteve, unë tërhiqem nga propozimi për arsye se punoj në Prishtinë dhe nuk jam tërë kohë në Podujevë andaj konsideroj se nuk mund të jem e angazhuar aq sa duhet.

znj.Valbona Kadriu Podvorica, zëvendës kryesuese e Komitetit, pra kemi dy propozime, ndërkohë e propozuara znj.Albina Avdiu u tërhiq për arsye siç i ceku ajo, kurse ka mbete vetëm z.Xhafer Ademi i propozuar. Andaj e hedh në votim.

Konstatim:

Pas votimit njëzëri z.Xhafer Ademi, zgjedhët Kryesues i Komitetit për Komunitete.

znj.Valbona Kadriu Podvorica, zëvendës kryesuese e Komitetit, uroj Kryesuesin e sapo zgjedhur të Komitetit për Komunitete dhe ftoj të merr detyrën qysh nga ky moment.

z.Liman Zeqiri, shëf e ZKKK-së, theksoi, unë si Shëf i ZKKK nuk deshta të jap biografi për asnjërin prej të propozuarve, njëkohësisht e falënderoj sinqerisht znj.Albina Avdiu e cila shumë në mënyrë korrekte e tha se z.Xhafer Ademi është më me përvojë dhe është më i angazhuar sa i përket bashkëpunimit me Komunën por edhe me komunitetet jo shumicë, dhe si rrjedhojë u tërhojë nga gara për Kryesues/e.

Unë me z.Xhafer Ademin punoj dhe bashkëpunoj qe 18 vite, i cili udhëheq një organizatë joqeveritare që quhet "Qëndrimi" e që ka qenë një bashkëpunëtor i shkëlqyeshëm me institucionet lokale dhe qendrore por edhe me organizatat vendore dhe ndërkombëtare si UNHCR, UNDP, IOM, VOICE OF ROMA si dhe shumë Organizata tjera, e që përmes z.Xhafer Ademit janë ndihmuar shumë komunitetet jo shumicë në Komunën e Podujevës, me theks të veçantë procesit të arsimit dhe i njëjti asnjëherë nuk ka hezituuar por ka qenë kooperativ dhe kërkues në këtë fushë e cila mund të themi se është fusha më e ndritshme, andaj kontributi i tij është i mirë. Unë e përgëzoj për detyrën e re dhe për punët që e presin në vazhdim dhe do të jem shumë bashkëpunues dhe komunikues me Kryesuesin e sapo zgjedhur të Komitetit për Komunitete duke uruar që Ky Komitet të jetë shembull për të mirë ashtu siç ka qenë në të kaluarën e që unë si Shëf i ZKKK-së jam mburrë gjithëherë me punën, aktivitetet dhe sukseset e Komitetit për Komunitete të Komunës së Podujevës.

2. Ekstraktet e procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 28.09.2018 dhe 06.11.2018

z.Xhafer Ademi, Kryesues i sapo zgjedhur i Komitetit, theksoi, fillimisht dëshiroj të falënderoj të gjithë anëtarët e Komitetit për Komunitete për besimin e dhënë që unë të jem Kryesues i Komitetit për Komunitete. Uroj që bashkërisht të kemi suksese dhe punë të mbarë sa i përket kompetencave dhe përgjegjësiive të Komitetit për Komunitete. Do të jem bashkëpunues me të gjithë pa dallime, dhe do ta shfrytëzoj gjithë përvojën time për të cilën në pika të shkurtra e përmendi edhe parafolësi shëf i ZKKK-së z.Liman Zeqiri. Kam qenë edhe më parë anëtar i këtij Komiteti dhe kemi qenë Komiteti më i mirë në Kosovë, andaj besoj se në bashkëpunim me Ju do ta vazhdojmë atë praktikë të mirë që ka qenë duke synuar gjithnjë suksese edhe më të mira.

Në rend dite kemi dy ekstrakte të procesverbaleve, andaj urdhëroni nëse ndokush ka diçka rreth tyre mund të merrni fjalën, nëse jo kalojmë në votim.

Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratuan dy ekstraktet e procesverbaleve sipas kësaj pike të rendit të ditës.

3. Formimi i grupit punues për hartimin e planit të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2019

z.Xhafer Ademi, Kryesues, theksoi, kemi të bëjmë me formimin e një grupi punues i cili do të ketë për detyrë hartimin - përgatitjen e planit të punës së Komitetit për vitin 2019, andaj urdhëroni jepni ide dhe propozime si të veprojmë më tutje.

z.Liman Zeqiri, shef e ZKKK-së, grupi në fjalë mund të përbëhet nga 5 anëtarë, kryesuesi me automatizëm pastaj edhe 4 anëtarë tjerë të Komitetit.

Pas propozimeve të bëra, u konstatua se njëzëri formohet grupi punues për hartimin e planit të punës së Komitetit për vitin 2019, në këtë përbërje:

- | | |
|--------------------------------|----------|
| 1. Xhafer Ademi, | kryesues |
| 2. Benjamin Ejupi, | anëtar |
| 3. Valbona Kadriu – Podvorica, | anëtare |
| 4. Doruntina Hasani, | anëtare |
| 5. Albina Avdiu, | anëtare |

4. Informatë për rastet e kthimit dhe riintegrit të qytetarëve në shtëpitë (pronat) e tyre

z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK-së, e paraqiti informatën, ndër të tjera theksoi, në kuadër të ZKKK-së është edhe një çështje shtesë që na u është shtuar, bëhet fjalë për riatdhesimin si çështje mjaft komplekse e cila ka ardh pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës respektivisht pas debateve të bëra në Bruksel apo në Parlamentin e Evropës ku në bazë të një Marrëveshje mes Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverive të shteteve të Evropës kanë rëndë dakord që pas 28 korrikut 2010 nuk ka më azil politik as azil ekonomik dhe në bazë të kësaj të gjithë ata qytetarë të Republikës së Kosovës të cilët nuk e kanë pas të rregulluar dokumentacionin janë detyruar që varësisht prej situatave dhe rrethanave të kthehen në vendin e tyre të origjinës ose vendlindjes së tyre dhe në kuadër të kësaj palët janë pajtuar që kthimi mos të bëhet përnjëherë për të gjithë duke marrë parasysh që Kosova nuk mund të përballoj ndonjë fluks të madh për shkaqe ekonomike, por që ky kthim është bërë afërsisht 5000-6000 persona brenda secilit vit, proces i cili ende vazhdon. Jemi në dijeni se fundi i vitit 2014 dhe fillimi i vitit 2015 ka qenë në valë jashtëzakonisht e madhe e largimit të qytetarëve tanë drejt shteteve të Bashkimit Evropian që për ne ka qenë shumë shqetësuese dhe në këtë kontekst edhe qytetarë të komuniteteve jo shumicë kanë qenë në numër të madh që kanë emigruar, mirëpo në kuadër të riatdhesimit si një proces i kthimit ata persona janë duke u kthyer vazhdimisht por që paraprakisht është dashtë të mobilizohen organet qendrore dhe ato lokale për një gjë të tillë e që në bashkëpunim mes tyre janë themeluar edhe komisionet për riatdhesimin dhe riintegrimin e atyre personave, proces të cilin e udhëheqë Ministria e Punëve të Brendshme në bashkëpunim dhe koordinim me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministrinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, të cila kanë departamentet dhe komisionet e veçanta për këtë çështje. Kostot e këtij procesi janë të larta ku përfshihen, banimi me qira, pakot ushqimore, ndihma për dimër, trajtimet mjekësore, rindërtim dhe rinovim i shtëpive apo orendi shtëpiake, mbështetje për personat e

cenueshëm nga sëmundjet e ndryshme, pra këto janë ndër çështje kryesore që Qeveria ndan buxhet por që është edhe një buxhet i ndarë nga Bashkësia Evropiane. Në kuadër të kësaj edhe ne në Komunën e Podujevës kemi të themeluar me kohë Komisionin komunal i cili përbëhet nga të gjitha Drejtoritë pothuajse dhe fushat përkatëse, komision i cili udhëhiqet nga Zyra për integritet evropiane dhe Zyra komunale për komunitete dhe kthim. Gjatë vitit 2018 në Komunën e Podujevës janë riatdhesuar 183 persona, 60 prej tyre janë familjarë, 40 prej tyre janë persona individual pa familje, 35 prej tyre kanë qenë nxënës të shkollave fillore dhe të mesme me të cilët jemi marrë më seriozisht sa i përket trajtimit të tyre dhe për këtë falënderojmë Drejtorinë e Arsimit për mundësinë e procesit mësimorë shtesë që ata nxënës të ambientohen dhe ta vazhdojnë procesin e rregullt mësimorë aty ku e kanë lënë, por në raste të tilla nëse nxënësit në fjalë kanë mbajtur shkollimin në vendet ku kanë qëndruar është e nevojshme dokumentacion shtesë dhe nostrifikim i dokumentacionit gjë e cila më shumë bie në kompetencë të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë. Familjet të cilat kanë pasë nevojë për ndihma emergjente janë të paraqitura në Informatë ku çështja më e ndjeshme ka qenë strehimi por për fat të mirë nuk ka pas raste të shumta ashtu sikurse në Komunat tjera. Kanë qenë 10 familje që kanë qenë përfituese të strehimit të përkohshëm të cilave ende vazhdojmë t'ju paguhet qiraja, 5 familje kanë qenë përfituese të trajtimit mjekësorë dhe medikamente, 6 familje me pako dimërore dhe dru për ngrohej, 3 familje orendi shtëpiake dhe 6 familje kanë hyrë në skemë sociale të cilat kanë qenë me gjendje të rëndë sociale ekonomike dhe që kanë plotësuar kriterin që të kenë fëmijë nën moshën 5 vjeçare.

Pjesa tjetër e personave të riatdhesuar ju referohen Zyrës për integritet dhe Zyrës komunale për komunitete dhe kthim, dhe ne kemi bashkëpunim të mirë me organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare siç janë, IOM, dhe të tjera që kanë destinacion çështjen përkatëse dhe merren kryesisht me personat e riatdhesuar nga vende të ndryshëm. Normal që këto organizata ndihmojnë personat e riatdhesuar, me pako ushqimore dhe higjienike, strehim, medikamente, orendi shtëpiake, renovim të shtëpive, mjete financiare etj të ngjashme atyre personave që kthehen nga vendet e tyre përkatëse dhe normal që marrin edhe shënime. Vlen të theksohet se shumica e këtyre personave të riatdhesuar janë fokusuar në themelimin e bizneseve të vogla, kryesisht në veprimtari të ndryshme që ata persona kanë aftësi për ndonjë projekt të vogël në mënyrë që jetë përfitues i shumës deri në 3000€, gjë e cila mundësohet apo menagjohet nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale por edhe nga Organizata UNDP, ku fillimisht persona të tillë lajmërohen në Zyrën për integritet evropiane, sistemohen në sistemin për menaxhimin e resurseve, ju merren të gjitha të dhënat dhe ju jepet një konfirmim që ai persona është i riatdhesuar, pastaj drejtohen në Entin për punësim, ku pastaj detyrohen të mbajnë një trajnim shtesë 1 muhor në Qendrën përkatëse për Aftësim Profesional, pajisen me certifikatë të biznesit varësisht prej aftësive që kanë, mandej hartojnë projektin e veçantë biznesor si dhe me disa mjete vetanake mund të hapin biznese të vogla sa për rigjenerim të të ardhurave me synim të rritjes së tyre varësisht kapaciteteve që kanë. Në kuadër të këtyre, është komisioni përkatës pranë Departamentit për ri integritet në Ministrinë e cekura dhe në bashkëpunim edhe me zyrtarin për integritet evropiane të Komunës, dalin në terren marrin të gjitha të dhënat dhe dokumentacionin përkatës sa i përket aftësive dhe hapësirave për hapje të biznesit, punësimit etj. Pra kjo është forma dhe mënyra e procesit të riatdhesimit, proces ky paksa i komplikuar por megjithatë ne si Komunë e Podujevës kemi qenë shumë të angazhuar në këtë drejtim dhe nuk kemi pas asnjë problem.

z.Xhafer Ademi, Kryesues, falënderoj z.Liman Zeqirin për informatën e dhënë sa i përket procesit të riatdhesimit. Vlen të theksohet se përfitimet nuk varen krejt nga Komuna sepse kanë të bëjnë edhe me Ministrinë përkatëse kështu që në këtë aspekt, sa jam në dije nuk jemi keq ne si komunë.

5. Të ndryshme

z.Xhafer Ademi, Kryesues, dëshiroj të jap vetëm një informatë të shkurtër, të gjithë nxënësit e komunitetit jo shumicë në Komunën e Podujevës që vijojnë procesin mësimor në shkolla të mesme janë përfitues të bursave, kjo falë angazhimit të Organizatës joqeveritare “Qëndrimi” dhe asaj URAIN, kemi arrit që të gjithë nxënësit në fjalë në territorin e Komunës së Podujevës, edhe pse kanë qenë shumë Komuna tjera në konkurrencë, të janë përfitues të bursave. Numri i nxënësve përfitues ka është 27, nga klasa 10 deri në klasën e 13.

z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK-së, theksoi, sa për sqarim, përfituesit e bursave që u ceken nga Kryesuesi, jam në dijeni dhe falënderojmë për një gjë të tillë, por numri i tyre është 26 nxënës dhe 2 studentë, e them këtë duke qenë në dijeni nga evidenca që mbaj sepse ne si ZKKK ju lëshojmë vërtetime atyre nxënësve në mënyrë që ata të mund të aplikojnë. Organizata përkatëse e cila ka ndihmuar dhe vazhdon ta ndihmoj komunitetin jo shumicë në Komunën e Podujevës është Organizatë Zvicerane, mirëpo falënderimi shkon edhe për angazhimin e OJQ-së “Qëndrimi”.

Jemi në dijeni të gjithë se kur një shoqëri është e arsimuar edhe fati i një populli varet nga ajo shoqëri, andaj ne vazhdimisht bëjmë përpjekje për arsimim sa më të lartë të komuniteteve jo shumicë në mënyrë që niveli të jetë sa më i lartë.

Këtë vit nuk jam ende në dijeni se a janë pajisur me tekste shkollore nxënësit e shkollave të mesme të komunitetit ashkalinj ngase këtë vit për dallim nga vitet e kaluara kemi paksa probleme sa i përket sigurimit të tyre. Pastaj ajo që më gëzon më së shumti është se asnjë nxënës nga komunitetit jo shumicë i cili ka qenë i interesuar të regjistrohet në shkolla të mesme nuk ka mbet jashtë procesit mësimor, pavarësisht kushteve dhe kriterëve të parapara.

znj.Doruntina Hasani, pyetje, a keni informata rreth procesit mësimor të të riadhesuarve.

z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK-së, përgjigje parafolëses, procesi i riadhesimit është proces për të gjitha komunitetet, mirëpo nëse mendohet për OJQ-në “Voice of Roma” e cila organizon mësim shtesë për nxënësit e komunitetit jo shumicë, ka dy paralele, një në Lagjen “Ali Ajeti” dhe një në shkollën e re “DR Ibrahim Rugova”, pra mbahet mësim shtesë për të gjithë të interesuarit.

z.Xhafer Ademi, Kryesues, sa për sqarim rreth kësaj, kemi të bëjmë me ata nxënës të komunitetit jo shumicë të cilët mësimin ose detyrat që nuk mund të arrijnë të kryejnë ose të mësojnë sa duhet në procesin e rregullt mësimor, mbajnë orë shtesë, apo në ato lëndë ku vërehen qalime mbahen ligjërata dhe në mënyrë që të jenë në hap me të tjerët. Kështu që kjo ka ndihmuar mjaft shumë neve si komunitet jo shumicë sa i përket procesit mësimor të nxënësve të komunitetit për çka jemi falënderues. Sa i përket nxënësve të riadhesuar, ju them se të gjithë janë duke vijuar procesin mësimor pa kurrfarë problemi, ashtu sikurse nxënësit tjerë.

Meqë nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën, Kryesuesi e konstatoj të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 11.05’

Procesverbalin e mbajti
Enis Sheholli

Zëvendës kryesuesja e Komitetit
Valbona Kadriu – Podvorica_____

Nr. 01-060/03-0001866/19
Podujevë,
09 janar 2019

Kryesuesi i zgjedhur i Komitetit
Xhafer Ademi_____